



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.11.2018 ora 09.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i programit 6-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 26 nëntor – 28 dhjetor 2018.
2. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 – 21 dhjetor 2018.
3. Raportim periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit Evropian, periudha 1 maj - 31 tetor 2018.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Senida Mesi –	Zëvendëskryeministre
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Eduard Shalsi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Milva Ekonomi -	Nënkryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Blendi Çuçi -	Nënkryetar i Komisionit për Integrimin European
Elisa Spiropali -	Nënkryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Mungojnë:

Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
	Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin Europian
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Erion Braçe -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Marrin pjesë:

Mimoza Pano -	Drejtoreshë e Shërbimit të Seancës Plenare
---------------	--

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Hapim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve me rend dite:

1) Miratimi i programit 6-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 26 nëntor – 28 dhjetor 2018.

2) Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 – 21 dhjetor 2018.

3) Raportim periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit Evropian, periudha 1 maj - 31 tetor 2018.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin jeni njohur paraprakisht në rrugë elektronike.

Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, projektrezoluta etj.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Janë parashikuar 3 seanca plenare përkatësisht në datat: 3, 13 dhe 20 dhjetor, si gjithnjë ditën e enjte

ora 10.00, përjashto seancën e 3 dhjetorit që do të zhvillohet ditën e hënë, ku do të diskutohet dhe votohet për buxhetin nën për nën dhe paketën fiskale.

Dua të theksoj që, nëse mendimi i Komisionit të Venecias për nënsmën e opozitës për vettingun e politikanëve do të vijë brenda afateve kushtetuese për sesionin parlamentar, komisioni i Ligjeve dhe Këshilli i Legjislacionit duhet të mbarojnë punën me shqyrtimin e nënsmës. Po kështu dhe komisioni për Reformën Zgjedhore me amendimet e Kodit Zgjedhor. Nëse opozita do të vijë në komision në do të ecim, me qëllim që të miratojmë draftin që do të paraqitet. Kam komunikuar edhe me zotën Çuçi që të më bëjë gati draftin dhe të dyja këto çështje do të jenë në axhendën e këtij sesioni parlamentar.

Meqenëse jemi përpara dy të panjohurave, ne nuk e kemi përfshirë në këtë kalendar që po miratojmë sot, por nëse ato do të bëhen realitet, sigurisht që mund të përfshihen ose në datën 20 ose më 27 dhjetor 2018. Megjithatë çështja mbetet e hapur.

Mendime, sugjerime në lidhje me programin dhe kalendarin?

(Anëtarët e Konferencës shprehën unanim dakord në lidhje me programin dhe kalendarin). Meqenëse jeni dakord le t'ia paraqesim seancës për miratim.

Kemi dhe një njoftim tjetër. Nga Qeveria janë depozituar sot dy projektligje të reja. Projektligji “Për përfundimin e proceseve tranzitore të pronës në Republikën e Shqipërisë” dhe projektligji “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”. Të dy këto p/ligje do të jenë pjesë e programit të punës dhe kalendarit 3-javor.

Lidhur me Raportimin periodik të planit të veprimit të Kuvendit pr përmbushjen e rekomandimeve të Progres-Raportit 2018, ka pyetje?

Vasilika Hysi – Tek forcimi i rolit kontrollues të Kuvendit në çështjet e Integritetit Evropian, jemi me masa të pa realizuara dhe kjo është në *screening*.

Mimoza Pano – Kjo çështje i përket Këshillit Kombëtar të Integritetit evropian, i cili nuk është mbledhur një herë në dy muaj, sipas përcaktimit në ligj, sepse kryetari i Këshillit, si përfaqësues i opozitës nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, meqë opozita nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve dhe në seancat plenare. Por, mund të kërkohet dhe nga 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote të KKIE-së. 1/3 e anëtarëve me të drejtë vote që mund ta mbledhim Këshillin janë kryetarët e komisioneve që mund të firmosin dhe disa përfaqësues nga shoqëria civile.

Taulant Balla – Të bëjmë një kërkesë dhe ta mbledhim Këshillin Kombëtar për Integrimin Evropian më datë 4 dhjetor.

Gramoz Ruçi – Sugjerime të tjera? Zoti Çuçi gati jeni me Reformën Zgjedhore?

Blendi Çuçi – Gati jemi, përpjekjet po bëhen. E kemi bërë të qartë që brenda dhjetorit duhet të miratohet, ndërkohë i kemi dhënë një lloj konsensusi për të filluar dhe eksploruar me punën e teknologjisë së informacionit për votimin. Kemi rënë dakord që, Kryeministri të ngrejë një grup pune edhe me përfaqësinë e Partisë Demokratike në mënyrë që t'i paraprijmë procesit, që KQZ-ja kur të miratohet ligji dhe kur ligji të hyjë në fuqi të jetë gati për të shpallur tenderin për sistemin, e t'i ketë gati termat e referencës. Pra t'i bëjë grupi i punës që do të ngrihet nga Kryeministri. Prandaj ky është një hap pozitiv që të kapet koha. P/ligji është hartuar edhe me përfaqësinë e ekspertëve të Partisë Demokratike dhe kjo me një korrespondencë publike, e cila është e gatshme për t'u vënë në dispozicion të publikut.

Gramoz Ruçi – Dakord atëherë, le të vijojmë me seancën plenare.

MBLEDHJA MBYLLET